



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____	Nr. Prot. _____
Dep. <u>DPKI</u>	Br. Prot. <u>06-01/2735/22</u>
Dep. _____	Prot No. _____
Nr. l faq. _____	Data _____
Broj stranica <u>03</u>	Datum <u>01-07-2022</u>
Nr. pages _____	Date _____
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.06.2022, mori:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPK-06-2019/22*, për zyrtarin e lartë z. Sabedin Vishi, Nënkyetar i Komunës së Kaçanikut, për shkak të është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli *AKK-DPK-06-2019/22*, që për trajtim ka pasur zyrtaren e lartë, është zhvilluar procedura e paraparë për trajtimin e situatave të konfliktit të Interesit.

Ky rast ka filluar të trajtohet sipas detyrës zyrtare dhe sipas procedurës Agjencia fillimisht ka marrë informacione nga ARBK (Agjencia Për Regjistrimin e Bizneseve), ku është identifikuar se zyrtari z. Sabedin Vishi, figuron të jetë pronar dhe person i autorizuar në biznesin privat me emër "Sabedin Vishi B.I".

Pas konfirmimit të informacionit, Agjencia kundër Korrupsionit, sipas procedurës së paraparë, fillimisht e ka njoftuar zyrtarin e lartë me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese zyrtari në fjalë ka kontaktuar me zyrtaret e AKK-së, dhe është njoftuar për rastin e iniciuar për të, si dhe për obligimet ligjore që ka si zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Në këtë komunikim i është dhënë sqarimi se nuk mund të ushtroni edhe funksionin menaxhues në biznesin privat, sepse kjo është e ndaluar me neni 13 (paragrafi 1) të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit, në të cilën thuhet:

1. *Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.*

Ndërsa me nenin 19 të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit parashihen masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave. Dispozitat e nenit në fjalë përcaktojnë se:

1. *Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrethanave:*
 - 1.1. *transferon interesin privat dhe të drejtat në drejtimin e ndërmarrjes sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij ligji; [...];*
 - 1.3. *jep dorëheqjen nga detyrat, funksionet ose veprimtaritë që janë në konflikt ose të papajtueshme me funksionin e tij publik;*
 - 1.4. *dorëhiqet nga funksioni publik.*

Gjatë këtij komunikimi të quajtur ndryshe edhe si ballafaqim i fakteve, zyrtari i lartë z. Sabedin Vishi, është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se nuk ka pas njohuri në lidhje me kufizimet e tilla, me gjithë atë, edhe pse biznesi nuk zhvillon aktivitet do të ndërmerri veprime të menjëhershme në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrim të funksionit publik brenda afatit sa me të shkurtër.

Në ndërkohë, Agjencia ka pranuar njoftimin, informacionin zyrtar nga z. Sabedin Vishi, me të cilën na ka njoftuar se ka ndërmarr veprimet e nevojshme dhe ka shuar në mënyrë vullnetare biznesin me emër “Sabedin Vishi B.I” .

Agjencia kundër Korrupsionit, konstaton se me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë, Sabedin Vishi, Nënkyetar i Komunës së Kaçanikut, duke e shuar në mënyrë vullnetare biznesin privat me emër “Sabedin Vishi B.I”, janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

